

Nr. Prot. 41/1
Dh. 25.01.2023

STATUTI

1

SHOQERISE AKSIONARE ME OFERTE PRIVATE

"SPITALI CONTËNENTAL" SH.A.

PJESA

DISPOZITA TI PËRGJITHSHME

KAPITULLI 1

FORMA LIGJORE, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

Forma ligjore dhe Emërtimi i Shoqërisë

1. Shoqëria është një person juridik shqiptar, e krijuar nën formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe është shndërruar në shoqëri aksionere me ofertë private, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit Civil në fuqi, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.
2. Shoqëria ka fituar personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar, pranë QKB-së në datë 08.01.2015, identifikuar me NUS L51308022F.
3. Emërtimi i shoqërisë është "Spitali Continental" ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa sh.a, e Cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë Aksionere.
4. "Spitali Continental" sh.a.do të ketë logon dhe vulën e saj, e Cila aprovet nga mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Objekti i Veprimtarisë

1. Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese e kuruese dhe qendrave ambulatorë të diagnostikimit në territorin e Shqipërisë, konsulencë në këtë fushë.
- Organizimi i qendrave të trajnimit dhe programe për edukimin e trajnimit të doktorëve, infermierëve dhe personelit administrativ.
- Aktivitet tregtar për import-eksport të aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, mjete farmaceutike, shërbime logjistike për materiale/lëndë farmaceutike të përdorura në strukturat e diagnostikimit.

- Funksionimi dhe administrimi i farmacive të shitjes me pakicë dhe tregtimi me pakicë i barnave dhe produkteve farmaceutike. Funksionimi dhe administrimi i restoranteve dhe i lokaleve, bar kafe etj.
 - Ofrimin e shërbimeve mjekësore spitalore jopublike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me marrëveshjet ndërkombëtare për shërbimet shëndetësore transkufitare.
2. Përshkrimi i objektit të shoqërisë ka natyrë indikuese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit të saj shoqëria mund të bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik në çdo mënyrë që e gjykon të dobishme.
 3. Shoqëria në çdo kohë mund të ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 3

Kohëzgjatja

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.
2. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 4

Selia

1. Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: “, Rruga Ali Demi, Ambientet e ish Kombinatit Poligrafik, Godinë 2 Katëshe, ngjitur me Kryegjyshatën, Njësia Bashkiake Nr.1
2. Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degë ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e shoqërisë si dhe legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI II

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 5

Regjistrimi i Kapitalit

1. Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100 000 000 Leke (njëqind milion lekë), i ndarë në 100 (njëqind) aksione, me vlerë nominale 1000 Lekë (njemije lekë) secila. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar nga aksionerët e shoqërisë.
2. Aksionet do të regjistrohen dhe evidentohen në regjistrin e aksioneve, të draftuar në momentin e depozitimit të statutit bazuar në kapitalin vijues të mbartur nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, shndërruar tashmë në shoqëri aksionare.

NENI 6

Aksionerët e Shoqërisë

1. Kapitali i Shoqërisë është 100 000 000 Leke (njëqind milion lekë), i ndarë në 100 (njëqind) aksione, me vlerë nominale 1000 Lekë (njemije lekë) secila. Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga aksionerët e saj. Në momentin e miratimit të këtij statuti, ky kapital zotërohet nga Aksioneri i vetëm si më poshtë:
 - Aksioneri i vetëm, Kryegjyshata Botërore Bektashiane me 100 (njëqind) aksione me vlerë nominale 1000 (njemije) lekë shqiptare, në total për shumën 100 000 000 (njëqind milion) lekë që përbën 100% të kapitalit të shoqërisë.
2. Aksionet janë tërësisht nominale dhe janë lirisht të transferueshme sipas ligjit shqiptar në fuqi.
3. Aksioneri përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tretëve vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara. Çdo aksion i jep të drejtën e një vote titullarit të tij.

NENI 7

Aksionet dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre

1. Aksionet e shoqërisë janë nominale dhe lirisht të transferueshme sipas ligjit shqiptar në fuqi.
2. Çdo aksion jep drejtën e një vote.
3. Shoqëria do të përgatisë dhe do të mbajë në selinë e saj regjistrin e Aksionerëve i cili tregon numrin e aksioneve të zotëruara nga çdo Aksioner.
4. Çdo aksion i jep zotëruesit të tij të drejtën e pjesëmarrjes në fitimin e Shoqërisë në përpjestim me numrin e aksioneve të zotëruara dhe në rast likuidimi i jep atij të drejtën e marrjes së pjesës që i takon nga aktivet e mbetura të Shoqërisë.
5. Aksioneri përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundërt të tretëve vetëm me vlerën e pashlyer të aksioneve të nënshkruara.

NENI 8

Mënyra e fitimit dhe kalimi të aksioneve

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të aksioneve:

1. Aksionet e një shoqërie aksionare dhe të drejtat, që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë, në çastin e formimit të shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
2. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria, në përputhje me pikën 1 të nenit 119 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.



NENI 9

Transferimi i Aksioneve

1. Transferimi i aksioneve kushstëzohet nga e drejta e parablerjes, në favor të aksionarëve të tjerë.
2. Kur një aksioner dëshiron të transferojë aksionet e tij, pjesërisht ose tërësisht, atëherë Aksioneri duhet të njoftojë më shkrim Këshillin Mbikqyrës, duke specifikuar çmimin e shitjes për çdo aksion, në mënyrë që aksionerët e tjerë të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes së aksioneve. Këshilli i mbikqyrjes njofton me shkrim Aksionerët e tjerë brenda 10 (dhjetë) ditësh nga data e njoftimit të kësaj transferte.
3. Aksionerët e mbetur do të njoftojnë Këshilli mbikqyrës në lidhje me vendimin e ushtrimit të së drejtës së parablerjes, brenda 3 muajve nga data e marrjes së njoftimit të dërguar nga Këshilli i Mbikqyrjes.

NENI 10

Zmadhimi i Kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet kontributit në natyrë apo të holla siç parashikohet në ligj.
2. Rritja e kapitalit mund të fillojë me emetimin e aksioneve të reja ose duke rritur vlerën e aksionit ekzistues. Aksionet do të regjistrohen dhe vlera nominale do të paguhet plotësisht në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
3. Aksionet e reja do të lëshohen me vlerë nominale ose me vlerë të rritur.
4. Rritja e kapitalit do të jetë subjekt i së drejtës pre-emptive për ta regjistruar proporcionalisht këtë rritje të kapitalit.
5. Kapitali do të rritet brenda 30 ditëve nga data e vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Në rast se para emetimit të aksioneve të reja, që paguhet në *cash*, kapitali nuk është paguar plotësisht, emetimi do të konsiderohet i pavlefshëm.
6. Regjistrimi i aksioneve i jep të drejta prioritare rritjes së kapitalit. Në rastin e rritjes së kapitalit nëpërmjet kontributeve në *cash*, të drejta prioritare u jepen Aksionarëve të Shoqërisë në mënyrë proporcionale me aksionet që mbajnë. Çdo klauzolë që bie në konflikt me këtë do të jetë e pavlefshme.
7. Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme është organi i vetëm kompetent që ka të drejtë të marrë vendime për rritjen e kapitalit bazuar në raportin e administratorëve, mbikëqyrur dhe kontrolluar nga Këshilli Administratorëve.
8. Në rast se kapitali është rritur nëpërmjet rezervave e përfitimeve, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të marrë vendim në mbledhjen e parë n.q.se aksionerët ose përfaqësuesit e autorizuar që kanë në zotërim 6/7 e të drejtës së votës janë prezent.



NENI 11

Zvogëlimi i Kapitalit

1. Zvogëlimi i kapitalit do të autorizohet nga vendimi i Mbledhjes të Asamblesë së Përgjithshme, i cili mund t'ia delegojë të drejtën për zbatim Këshillit të Administratoreve.
2. Drafti për zvogëlimin e kapitalit do të komunikohet ekspertëve kontabël të licencuar, të paktën 45 ditë para procedimit të Mbledhjes të Asamblesë së Përgjithshme, e cila do të mbledhet në mënyrë specifike për të vendosur këtë draft. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të marrë këtë vendim bazuar mbi raportin e ekspertit kontabël.
3. Kur Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme i jep tagra Këshillit të Administratoreve të implementojë operacionin, procesverbalet e mbledhjeve shfaqen hapur dhe publikisht dhe operohet sipas Statutit.
4. Të gjitha procedurat për zvogëlimin e kapitalit do të kryhen në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare".

NENI 12

Rezerva ligjore dhe rezervat e tjera

1. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut.
2. Statuti mund të parashikojë krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore.
3. Shoqëria llogarit e ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni.

PJESA II

STRUKTURA E SHOQËRISË

NENI 13

Organet Drejtuese

1. Shoqëria do ta organizojë procesin e vendimmarrjes dhe mbikëqyrjes në përputhje me sistemin me dy nivele sikurse është vendosur në titullin e IV, kapitulli III të Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".
2. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:
 - Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve,
 - Këshilli i Mbikëqyrjes
 - Administratori/ët



KAPITULLI I
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
NENI 14

Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë dhe përbëhet nga të gjithë aksionerët e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin "Për shoqëritë Tregtare", e në veçanti nga dispozitat e nenit 148 të këtij ligji, të drejtat e aksionarëve, për çështjet e lidhura me veprimtaritë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme.

NENI 15

Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshime të statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës;
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
 - h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - n) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.
3. Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:
 - a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së



- veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
 - c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
 - ç) vendimet për investime;
 - d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrimin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 16

Mbledhja dhe mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji "Për Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e këtij statuti dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.
2. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe, në rastet e parashikuara nga ligji "Për Shoqëritë Tregtare", nga anëtarët e të këshillit mbikëqyrës apo nga aksionarët (aksionarët e pakicës) e përcaktuar sipas nenit 139 të ligjit "për shoqëritë tregtare".
4. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.
5. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
7. Në rastet e parashikuara në pikat 4 deri 6 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.
8. Dispozita e pikës 7 të këtij neni nuk zbatohet nëse blerjet, sipas pikave 5 dhe 6 të këtij neni, kryhen në bursë apo janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.

9. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mbahet në selinë e shoqërisë, apo në ndonjë qytet, provincë e kudondodhur brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për të cilën Aksionerët bien dakord paraprakisht.
10. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim, nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi (Vendi i përcaktuar, data) me shkresë apo me mesazh elektronik dhe rendi i ditës u dërgohen të gjithë aksionarëve, jo më vonë se 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
11. Vendimi i propozuar, bashkë me dokumentacionin që evidenton vendimet, do t'u dërgohet Aksionareve me e-mail, poste të rekomanduar, telefaks apo me metoda të tjera të sigurta elektronike.
12. Për çdo vendim të marrë, duhet të mbahet një procesverbal i shkruar i cili dokumentohet dhe ruhet nga administratori/ët e Shoqërisë dhe regjistrohet në librin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme. Çdo Aksioner ka të drejtën për tu përfaqësuar me prokurë në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare".
13. Kur parashikohet me ligj, disa prej vendimeve të aksionarëve mund të noterizohen nga një noter publik shqiptar.

NENI 17

Përfaqësimi në Asamble

1. Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga njëaksionar tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët dhe anëtarët e të këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerët ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

NENI 18

Pjesëmarrja me mjete komunikimi elektronike

1. Aksionarët, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
2. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;



- b) komunikimin e ndërsjellë, i cili u mundëson ortakëve të shprehen në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme në kohë reale, nga një vendndodhje tjetër;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
3. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar aksionarëve marrjen pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kusht që të merren masat teknike, të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

NENI 19

Kuorumi

1. Në rastin e çështjeve, që vendosen me shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionarët, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të aksioneve, me të drejtë vote. Kur asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 20 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse aksionarët, që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote, apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në votim personalisht ose votojnë me shkresë apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të nenit 18 të këtij statuti.
2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 20

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të aksionarëve, që marrin pjesë në votim, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 19 të këtij statuti, në lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e tjera, të renditura në nenin 15 të Statutit, me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin "Për Shoqëritë Tregtare", vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi aksionarët apo vendimet, që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë



ligj, në statut apo në vendime të tjera, kushtëzohet nga miratimi i aksionarit përkatës.

NENI 21

Të Drejtat, Detyrimet dhe Ndalimet e Aksionerëve

1. Çdo aksioner ka të drejtën të jetë i informuar mbi aktivitetin tregtar të Shoqërisë dhe mbi dokumente të tjera të lidhura me të, të cilat reflektojnë biznesin. Aksionerëve në bazë të një kërkesë me shkrim do t'u jepet informacion dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e shoqërisë në çdo kohë, përfshirë të drejtën për të kontrolluar të dhënat dhe dokumentet e Shoqërisë.
2. Çdo aksioner është i zgjedhshëm dhe ka të drejtë të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë, në përputhje me aksionet e regjistruara në Kapitalin e Shoqërisë.
3. Çdo aksioner mund të ndjekë Mbledhjen e Përgjithshme të Asamblesë.
4. Aksionerët kanë të drejta të tjera të parashikuara nga Statuti, nga marrëveshje angazhuese ndërmjet aksionerëve (këtu e në vijim Marrëveshja e Aksionerëve) dhe dispozitave të tjera të parashikuara nga ligji.
5. Shoqëria nuk mund të mbajë përgjegjësi për borxhet ose detyrimet personale të Aksionerëve.
6. Një Aksioner nuk lejohet të votojë në një mbledhje asambleje kur kjo e fundit vendos për:
 - a) Vlerësimin e performancës së këtij aksionari.
 - b) Anulimin e detyrimet e aksionerit.
 - c) Ngritjen e një padie kundër aksionerit.
 - d) Dhënien e një huaje aksionerit.

KAPITULLI II

KËSHILLI I MBIKQYRJES

Neni 22

Këshilli Mbikëqyrjes

1. Këshilli Mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të politikave tregtare dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin dhe merr vendime sipas rastit.
2. Këshilli i mbikëqyrjes përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve mund të rrisë këtë numër deri në 21, por kjo rritje duhet të jetë e arsyetuar dhe miratuar nga votat e Aksionerëve.

3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrjes janë individ, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe nuk mund të jenë persona juridik ndryshe emërimi i tyre është i pavlefshëm.
4. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrjes mund të jenë të çdo shtetësie dhe nuk është e nevojshme që të jenë shtetas shqiptarë.
5. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrjes nuk mund të jenë në të njëjtën kohë edhe administratorë të Shoqërisë, administratorë të shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë sipas parashikimeve të nenit 13 pika 3, të ligjit për shoqëritë tregtare. Në rast se një prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrjes do të emërohet si administrator, mandati i tij në Këshillin Mbikëqyrjes përfundon në datën e emërimit të tij në pozicionin e ri.
6. Anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrjes zgjidhen nga asambleja e përgjithshme me shumicën e votave të aksionarëve që marrin pjesë, Ata emërohen në këtë detyrë për një periudhë prej 5 vjetësh me të drejtë rizgjedhje.
7. Aksionarët, të cilët zotërojnë së bashku një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind ose një vlerë më të vogël të kapitalit të regjistruar, të kenë të drejtën të emërojnë një anëtar të këshillit të administrimit me një vendim të posaçëm.
8. Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrjes që pushon së qeni i tillë si pasojë e dorëheqjes, shkarkimit, paaftësisë apo vdekjes, do të zëvendësohet nëpërmjet emërimit të një anëtari të ri të zgjedhur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Anëtari i ri do të qëndrojë në detyrë deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të vjetër.

NENI 23

Të drejtat dhe detyrimet e Këshillit Mbikëqyrës

Detyrat dhe Funkcionet e Këshillit Mbikëqyrjes janë si më poshtë:

1. Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
2. Këshilli Mbikëqyrës miraton të gjitha veprimet e Administratorëve sipas rasteve të parashikuara nga ligji “Për Shoqëritë Tregtare” dhe nga ky Statut.
3. Të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t’i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t’u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
4. Të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë si dhe për prishjen e saj apo masa të tjera të nevojshme e të përshtatshme;
5. Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;



6. Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
7. Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecures së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikqyrjes për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të Mbikqyrjes për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
8. Të sigurojë që auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një audit ligjor, raporti i auditimit drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikqyrjes. Raporti i Këshillit Mbikqyrjes, përmendur në shkronjën "dh" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
9. Të emërojë dhe shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;
10. Të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
11. Këshilli Mbikqyrjes është përgjegjës për emërimin dhe shkarkimin e personave që do të mbajnë pozicionet pranë shoqërisë, si më poshtë:
 - a. Drejtuesit teknik mjekësor;
 - b. Shef i Departamentit të Financës;
 - c. Kryeinfermierit të përgjithshëm;
 - d. Shefit teknik të Laboratorit.
 - e. Kordinatorit (mjeksor, recepsinit dhe sherbimeve mbeshtetse)
12. Këshilli Mbikqyrjes miraton kriteret kualifikuese dhe përshkrimin e pozicioneve drejtuese të përmendura në pikën 11 të këtij neni, të propozuara paraprakisht nga Administratori i shoqërisë.
13. Administratori i shoqërisë propozon pranë Këshillit Mbikqyrjes personat të cilët plotësojnë kriteret e profilit të pozicionit drejtues të përmendura në pikën 11.
14. Këshilli Mbikqyrës miraton organigramën e shoqërisë dhe nivelin e pagave për çdo pozicion pune.
15. Këshilli mbikqyrës jep autorizimin paraprak për marrëveshjet e mëposhtme:
 - a) Të gjitha marrëveshjet e lidhura nga shoqëria, anëtarët e këshillit mbikqyrës ose Administratori;
 - b) Marrëveshjet e lidhura nga çdonjëri prej personave të përmendur më sipër drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësuesvë,
 - c) Marrëveshje të lidhura me një shoqëri aksionare dhe/ose subjekt tjetër ekonomik, në rast se një prej anëtrëve të këshillit mbikqyrës ose administratori i shoqërisë anonime është ortak i pakufizuar, administrator ose anëtar i këshillit administruar të shoqërisë aksionare dhe /ose subjekt ekonomik.

- d) Marrëveshje në lidhje me lëshimin e garancive, investimeve të parashikuara për vitin financiar;
 - e) Hapjen dhe mbylljen e veprimtarive ose dëgëve të shoqërisë, shitjen ose shkëmbimin e pasurive që janë pjesë e pandashme e kapitalit të shoqërisë;
 - f) Përfshirjen e shoqërisë në marrëdhënie kontraktore, duke përfshirë por pa u kufizuar në, shitje, blerje, huamarrje, huadhënie, qiramarrje apo qiradhënie të pajisjeve mjekësore, medikamenteve apo çdo material tjetër në pronësi të shoqërisë të merret miratim nga këshilli mbikqyrës
 - g) Pagesa të çfardolloy natyre, me përjashtim të pagesave të tatim-taksave, energjisë elektrike, ujit të pishëm, sigurimeve shoqërore dhe pagave të punëmarrësve.
 - h) Dispozitat e këtij nëni nuk zbatohen për marrëveshjet e lidhura me veprimtarinë e përditshme dhe të zbatuar në kushte normale
 - i) Merre informacion të hollësishëm me aktivitetin e spitalit dhe nderhyn në çdo moment bashkë me administratoren për zgjidhjen
16. Të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

NENI 24

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrjes

1. Nëse nuk përcaktohet një vend tjetër, Këshilli Mbikëqyrjes i mban mbledhjet e tij në selinë e shoqërisë.
2. Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrjes do të mbahen jo më pak se 2 (dy) herë në muaj, ose mbledhja pasardhëse e KM do të jetë me një distancë kohore jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë ditë) nga mbledhja paraardhëse.
3. Çështjet që kërkojnë miratimin e Këshillit Mbikëqyrjes mund të miratohen nëpërmjet qarkullimit të vendimit të shkruar dhe ky i fundit do të jetë i vlefshëm kur të gjithë anëtarët ta kenë nënshkruar atë.
4. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrjes janë të vlefshëm në rast se në procesin e vendimmarrjes janë të pranishëm më shumë se 1/2 e anëtarëve apo janë të përfaqësuar me prokurë dhe në rast se ato merren me shumicën e zakonshme të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Nëse kjo shumicë nuk merret, mbledhja do të shtyhet për një datë tjetër. Në rast balotazhi të votave, vota e kryetarit do të jetë përcaktuese.

KAPITULLI III

ADMINISTRATORI

NENI 25

Emërimi i Administratorit

1. Emërimi i Administratorëve të shoqërisë është kompetencë e Këshillit Mbikëqyrjes.



2. Këshilli i Mbikëqyrës emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet. Administratorët e shoqërisë mund të rizgjidhen.
3. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet si administrator i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.

ENI 26

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

Detyrat dhe Funksionet e Administratorit janë si më poshtë:

1. Menaxhojnë aktivitetin tregtar të shoqërisë përmes vënies në zbatim të politikave të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme dhe mbikëqyrura nga Këshilli Mbikëqyrës.
2. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. Kujdesen dhe mbajnë dokumentet dhe librat kontabël të nevojshëm;
4. Është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të aksioneve të shoqërisë dhe detyrohen të lejojnë aksesin në informacionin e regjistrit ndaj çdo aksionarei apo çdo personi tjetër që e kërkon.
5. Sigurojnë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe ia paraqesin atë Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme për miratim së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
6. Vendosin një sistem të paralajmërimit të hershëm në lidhje me zhvillimet që rrezikojnë ekzistencën e shoqërisë;
7. Kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
8. Raporton përpara Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me vënien në zbatim të politikave tregtare dhe me realizimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për rezultatin e Shoqërisë tregtare;
9. Nënshkruan çeqe, kontrata, kontrata qiraje, drafte, shënime, dokumente të tjerë apo instrumente që kanë lidhje me aktivitetin tregtar të shoqërisë; nënshkruajnë çdo dokument që ka nevojë për vulën e shoqërisë kur nënshkrimi i këtij dokumenti është i lejuar nga statuti apo nga ligji, përveç rasteve kur nënshkrimi i këtij dokumenti duhet të bëhet me një autorizim të lëshuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
10. Të kryen çdo detyrë tjetër të përcaktuar në ligje apo të autorizuar nga Asambleja e Përgjithshme herë pas here.
11. Miraton marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
12. Administratorët do të kenë kompetencën për të kryer të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë përveç atyre veprimeve që ligji apo



- ky statut ia njeh shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme apo Këshillit Mbikëqyrjes.
13. Administratori nuk mund të kryejë veprimet e mëposhtme, pa marrë paraprakisht miratimin e Këshillit Mbikëqyrës:
- i. Përfshirjen e shoqërisë në marrëdhënie kontraktore, duke përfshirë por pa u kufizuar në, shitje, blerje, huamarrje, huadhënie, qiramarrje apo qiradhënie të pajisjeve mjekësore, medikamenteve apo çdo materiali tjetër në pronësi të shoqërisë me vlerë më të madhe se 1'00'000 (një) lekë;
 - ii. Pagesa si në cash dhe nëpërmjet llogarive bankare të shumave më të mëdha se 1'00'000 (një milion lekë, me përjashtim të pagesave të tatim-taksave, energjisë elektrike, ujit të pishëm, sigurimeve shoqërore dhe pagave të punëmarrësve.
14. Të gjitha veprimet e administratorit që kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë u nënshtrohen miratimit nga Këshilli i Mbikëqyrjes sipas parashikimeve në këtë statut.
15. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
16. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.
17. Administratorët që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2 të nenit 163 të ligjit "Për shoqëritë tregtare", janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
18. Këshilli i Mbikëqyrjes mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KAPITULLI IV
AUDITIMI I SHOQËRISË
NENI 27

Auditimi Financiar

1. Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme emëron ekspert të certifikuar kontabël si auditues ligjor të pavarur për auditimin ligjor të Pasqyrave Financiare vjetore të shoqërisë. Audituesi ligjor do të jetë i emëruar për një periudhë të caktuar.
2. Shoqëria ka të drejtën të emërojë një ose më shumë auditues.



3. Auditues Ligjor i shoqërisë do të jetë: **shoqëria e auditimit**
“Albania Audit Partners”.

KAPITULLI V

FINANCAT E SHOQËRISË

NENI 28

Inventari, Pasqyrat dhe Viti Financiar

1. Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
2. Përrjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë në datën kur shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
3. Në përfundim të çdo viti financiar, Administratorët përgatisin inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjeter të Mbikëqyrjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi kontabilitetin.
4. Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, do tu kalojë aksionarëve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë ose mund të kalojë për investime me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Mbledhje e Zakonshme).
5. Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme mund të krijojë edhe lloje të tjera fondesh, përveç fondeve të parashikuara në nenin e mësipërm.

KAPITULLI VI

SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

NENI 29

Prishja e Shoqërisë

1. Shoqëria aksionare priset:
 - a) Kur mbaron periudha kohore për të cilën është themeluar;
 - b) Me vendim të asamblesë së përgjithshme;
 - c) Me hapjen e një procedure falimentimi;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - e) Me vendim të gjykatës;
 - f) Për arsye të tjera.
2. Ulja e numrit të aksionarëve në një të tillë nuk çon në shpërbërjen e shoqërisë.

NENI 30

Likuidimi i Shoqërisë

1. Përveç rasteve të parashikuara nga ligji, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shkrirjen e parakohshme të shoqërisë dhe vënien e saj nën likuidim, kur miraton një vendim me këtë objekt të propozuar nga administratorët ose Këshilli Mbikëqyrjes.
2. Për këtë qëllim, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, do të përcaktojë procedurat dhe mënyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar parashikimet e ligjit.
3. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, emëron një a më tepër likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet në kryerjen e procedurave të likuidimit.

KAPITULLI VII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 31

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha çështjet që nuk gjejnë një rregullim të posaçëm në këtë statut, në marrëveshje me palët, do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil në fuqi apo nga dispozitat e Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare" në fuqi.
2. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë si pasojë e interpretimit dhe zbatimit të këtij STATUTI, si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Aksionerëve të shoqërisë, do të zgjidhet nga Autoriteti Kompetent Gjyqësor që do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

NENI 32

Dispozita të Fundit

Ky statut është redaktuar nga aksioneri në 3 (tre) ekzemplarë me vlerë të njëjtë juridike në gjuhën shqipe.

AKSIONER I VETËM

Kryegjyshata Botërore Bektashiane

Përfaqësuar nga:

Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve

Haxhi Baba Edmond Brahima

Sh. Haxhi Baba Edmond Brahima

